

V E N D I M

Nr. 828, datë 30.12.1998

PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, NË FORMËN E SKRAPEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Mbrojtjes autorizohet, që brenda vitit 1999, të organizojë shitjen nëpërmjet ankandit të 15 000 tonë skrapeve që ka në administrim, nga nxjerrja jashtëpërdorimit të anijeve dhe mjeteve lundruese të Forcave të Mbrojtjes Detare, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që fitojnë ankandin mund të tregtojnë sasinë e skrapeve të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda vendit ose ta eksportojnë atë.

3. Të ardhurat që përfitohen nga shitja e skrapeve, të administrohen nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja A

LISTA **E MJETEVE LUNDRUESE (ANIJEVE) TË FORCAVE TË MBROJTJES DETARE** **QË HIQEN NGA FORMACIONI I LUFTIMIT** **(Nga Organika Luftarake e Mjeteve)**

Nr.	Emërtimi i anijes	Numri i bordit	Emërtimi taktik i anijes	Viti i prodh.	Viti i vënies shfryt.	Amort në përqind	Shënime
1.	Nëndetëse	331	Stuhija	1955	1956	123	
2.	“	332	Tufani	1955	1956	123	
3.	“	333	Rrufeja	1955	1956	123	
4.	“	334	Vetëtima	1955	1956	123	
5.	Gjuajtës Detar i Madh	323	Buna	1952	1955	126	Mbytur në Gjiun e Vlorës
6.	Mina Heqëse e Vogël	223	Vlora	1952	1955	126	Mbytur tek skaljera B.P

7.	“	224	Saranda	1952	1955	126	Mbytur tek skaljera B.P.
8.	“	226	Lezha	1954	1955	126	
9.	“	228	Himara	1952	1955	126	
10.	Katër Silurues	103	Shqiponja	1986	1968	87	
11.	“	202	Partizani	1954	1954	129	
12.	“	204	Sulmuesi	1954	1955	126	
13.	“	205	Shqiponja	1954	1955	126	
14.	“	206	Besniku	1954	1955	126	
15.	“	302	Patrioti	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin S.
16.	“	303	Delfini	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin S.
17.	“	306	Çeliku	1967	1968	87	
18.	“	307	Luftëtari	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
19.	“	308	Lavdia	1953	1954	129	Dëmtuar 40% e skafit (vjedh)
20.	“	309	Heroi	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
21.	“	310	Trimi	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
22.	“	311	Fitimtari	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin
23.	“	312	Shigjeta	1953	1954	129	
24.	“	401	Furtuna	1953	1968	87	
25.	“	402	Bubullima	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin Lir
26.	“	405	Rrebeshi	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin Lir
27.	Maune nafte 500 tonë	251	Cërriku	1957	1957	120	
28.	Anije polumbare	342	Finiqi	1976	1976	63	Mbytur pranë Brindizit
29.	Rimorkiator	523	Mulqinak	1957	1958	117	Mbytur në V. Bazimin S.
30.	Rimorkiator	=	S. Frashëri	1957	1958	117	Mbytur në V. Bazimin S.
31.	Stac. karik. lundrues	=	Oriku	1959	1959	114	
32.	Anije transporti	=	22 Tetori	1978	1978	57	Mbytur në Gjiun e Vlorës
33.	Anije transporti	=	Shkumbini	1958	1958	117	Mbytur Në Gjiun e Vlorës
34.	Çisterni nafte	424	Patosi	1954	1956	123	Mbytur në V. Bazimin S.
35.	Slur kapëse	345	Joni	1957	1958	117	Mbytur Në Gjiun e Vlorës
36.	Katër RADE	451	=	1957	1958	117	Mbytur Në kanalin e Otrantos
37.	Motoskaf M 20	=	=	1957	1958	117	Mbytur Vend

							Baz Pash.
38.	Pilotazhi	=	=	1980	1980	51	